VENDIM
Nr.460, datë 6.5.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË PATOS TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Patos të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Patos të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.813, datë 29.11.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Patos, të qarkut të Fierit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Patos për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Patos Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i trasferimit**
1	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
2-10,12-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
11	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
27-30,33-35	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
17-26	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore sportive.	Në pronësi
87-109	Varreza publike	Në pronësi
118-120,148-206,208	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
209	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi
36-86	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
121-131	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
132,136-138,140	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
133-135,139,141	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi
110-117,207	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi